

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Berisha flet nga Amerika për heqjen e "non-gratës": Vendimi ishte lobim nga Rama dhe Soros. Ndoqa rru gën e dinjitetit
ADRESA	https://kohajone.com/lajme/berisha-flet-nga-amerika-per-heqjen-e-non-grates-vendimi-isht-e-lobim-nga-rama-dhe-soros-ndoqa-rrugen-e-dinjitetit/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 19:27:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 19:26:37 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4f1e125f82ccc3c8ec355a91623d066886276f7a6017563c8ec3cdfd67d6bed2
TEKSTI	fb7584e8ce5ea8b3df5be513619f4081899e211a326ca13d7c4afb7ea72ceae
PAMJA	8f9f9ccbea777c9e09801c1daf6e948d00ef4c4f4919ac91da8a0506f36077c1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7b4364352abb841721c4bef76e7a4809b37f115d9eaf5b5428e51f4df932caa9
E MËPARSHMJA	aa7369a8e7f333301e55d2c992934f158e8e2f776152193b5adf31e68e47e880
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7b4364352abb841721c4bef76e7a4809b37f115d9eaf5b5428e51f4df932caa9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

 [LEXONI LAJMET E FUNDIT](#)

 [Facebook Icon KOHA JONË NË FACEBOOK](#)

 [Koha Jone Logo](#)

 [Facebook Icon KOHA JONË NË INSTAGRAM](#)

 [YouTube Icon KOHA JONË NË YOUTUBE](#)

[E përditshme e pavarur](#)

- [LAJME](#)
- [SPORTI](#)
- [EKONOMI](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [KOSOVA](#)
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [WEBTV](#)

- [MË TË FUNDIT](#) 

- [LAJME](#)
- [SPORTI](#)
- [EKONOMI](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [KOSOVA](#) 
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [TEKNOLOGJI](#)
- [SHËNDETI](#)
- [EDITORIAL](#)
- [WEBTV](#)

-  [Facebook Icon](#)
-  [Instagram Icon](#)
-  [YouTube Icon](#)

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: **Nikoll LESI**. Adresa e redaksisë: Rruga "Sami Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

[NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA](#)

 [Swiss Digital Logo](#)

 [Koha Jone Logo](#)

[E përditshme e pavarur](#)

- [LAJME](#)
-  [EURO24 Logo WEBTV](#)
- [SPORTI](#)
- [EDITORIAL](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [EKONOMI](#)
- [KOSOVA](#)
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [KULTURA](#)
- [TEKNOLOGJI](#)
- [SHËNDETI](#)

Berisha flet nga Amerika për heqjen e "non-gratës": Vendimi ishte lobim nga Rama dhe Soros. Ndoqa rrugën e dinjitetit

[Lajme](#) E Enjte, 10 Shtator 2026 21:26



Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha i cili ndodhet në një vizitë në SHBA ku ka marrë pjesë në Konventën e Partisë Republikane të presidentit Trump, ka folur për "Çim Peka LIVE", për këtë vizitë në Amerikë që pas shpalljes "non-grata" 5 vite më parë. Berisha ka treguar se vendimi ndaj tij ishte marrë pas lotimit korruptiv të Edi Ramës dhe Sorosit, për shkak se kishte kundërshtuar projektet e Sorosit.

Pjesë nga intervista:

 [Koha YouTube Channel](#)

Çim Peka: E pamundshmja ka ndodhur, Sali Berisha ka zhvilluar një takim të jashtëzakonshëm me diasporën e New Jerseyt. Një takim që në fakt nuk kishim menduar kurrë se do realizohej. Do të kemi këtë intervistë të shpejtë me zotin Berisha. Zoti Berisha përshëndetje. Kur e kishit filluar këtë betejë para 5 viteve, e kishit filluar për dinjitet, apo kishit menduar realisht se ti mund të arrijë të riktheheshe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës?

 [Swiss Digital Desktop Reklama](#)

Sali Berisha: Pa asnjë diskutim, që ditën e parë, kur kam vendosur të qëndroj ndaj këtij vendimi të paimagjinueshëm dhe thellësisht të padrejtë, kam qenë i bindur se e drejta do të triumfojë. Nuk e kam vënë ndonjëherë në dyshim, se kjo ditë nuk do vinte. Për arsye se arsyeja më e thyeshhtë ishte se kisha çdo fakt, çdo të dhënë se vendimi ishte totalisht lobim korruptiv i Edi Ramës dhe George Sorosit, dhe se nuk kishte në mënyrë absolute asnjë dokument apo fakt të qëndrueshëm.

 [Swiss Digital Mobile Reklama](#)

Dhe isha i bindur, isha i bindur se ajo një ditë, në një mënyrë ose në një tjetër, do të hiqej. Unë zgjodha një rrugë, që tani faktohet më e drejta, zgjodha rrugën gjyqësore. Por sado që në një aspekt ajo duket më femërore, më e vështirë, ajo u provua se unë kisha 100% të drejtë. Për kisha 100% të drejtë. Në këtë proces, unë kam disa mirënjohje shumë të vecanta. Kam një mirënjohje të madhe për

kongresmenin amerikan Lee Zeldin, që ia tha në sy, se ti s'ke asnjë fakt, asnjë dokument për Sali Berishën, por e ke marrë vendimin i bazuar, i nxitur nga Soros. Kisha një, një gazetar i Ëashington Times, i cili u mor në mënyrën më serioze këtë problem, dhe çfarë bëri, çfarë gjeti?

Punonjës të Departamentit të Shtetit gjeti ai, më thanë thotë ai, që procedura e Berishës është unike. Në cilin kuptim? Në kuptimin që s'ka kaluar në kanalet zyrtare që duhet të kalojë, por na ka ardhur nga sipër. Ka ardhur nga sipër, çka do të thotë që ishte marrë direkt nga Sekretari i Shtetit Blinken. Kështu isha i bindur, se një e padrejtë nuk do të mund të qëndronte për kohë të gjatë. Nuk kam pasur dyshim në këtë.

Çim Peka: Megjithatë me aq sa ju njoh si politikan, ju gjithmonë zgjidhni rrugët e sigurta në beteja, por pak të gjata. Ku e merr këtë durim, Sali Berisha?

Sali Berisha: Të themi të vërtetën, të jemi fikë të qartë me ty. Unë kësaj here zgjodha rrugën e dinjitetit. Realisht. Po unë kisha 8 vite, që nuk kisha asnjë funksion zyrtar në lidhshpirt të Partisë Demokratike apo të vendit. Kisha aq sa kisha autoritet moral dhe merresha, siç mund ta keni konstatuar me ato deklaratat e statutet e mia, me interesin kombëtar, çështjen kombëtare, dhe me krimin e organizuar, drogën. Këto me fjalë, duke u bindur se po mbroj interesin publik.

Tani, kisha kundërshtuar projektet e Soros-it si projekte të mirëfillta antishqiptare për në vlerësimin tim. Pra u bë një hakmarrje për shkak të lobimit të Soros-it dhe Rama e tha, ju në qoftë se ju kujtohet në 2019 kur më tha që 'ti s'kalon dot Atlantikun', tha që 'ky ka bërë konspiracion kundër politikës së jashtme të Shteteve të Bashkuara'. Unë konspiracion? Kurrë nuk kisha unë.

Unë kundërshtoja një projekt që absolutisht nuk ishte i Departamentit të Shtetit, s'ka qenë ndarja e shkëmbimit të territoreve fare, ishte një projekt i përgatitur nga OJQ në Beograd dhe i servirur. Ballkani i Hapur, nuk ishte një projekt i sugjeruar nga Departamenti i Shtetit në mënyrë absolute, ishte një projekt i sugjeruar nga Alex Soros dhe Vuçiç e Rama dhe kaq ishte. Tani, në këto kushte, 8 vite pasi unë s'kisha ndonjë funksion, kujtohet të vënë sanksione për korrupsion një njeriu që më kishte lavdëruar më shumë se këdo tjetër për luftën kundër korrupsionit. Çfarë ishte kjo? Kjo ishte lëndim në dinjitetin tim. Unë e kisha mbyllur prej 8 vitesh kapitullin tim, s'më kishte akuzuar askush kurrë, s'më kishte paditur kurrë njeri.

Dhe del ky njeri i nderuar që unë kisha respekt për të, me këtë akuzë. Atëherë natyrisht që unë isha njeri, po në një kohë që unë isha i harruar, unë isha një person i harruar në arenën ndërkombëtare, s'kisha, 8 vite, 8 vite kohë e pamasë, i lirë. Ky del edhe bën lajm me sanksionimin tim. Dhe unë pastaj mendova që, do ndjek një rrugë gjyqësore, dhe mediatike, nuk do lloboj. Nuk do lloboj dhe s'kam shpenzuar asnjë qindarkë. Kjo mbetet e vërteta.

Pra, ruga gjyqësore, e cila ishte ruga e një qytetari që kërkonte në sallën e gjyqit t'i vendoste dinjitetin e tij. Kjo e zemëroi shumë më tepër atë dhe anturazhin e tij dhe pastaj ndërmorën masat e tjera, tentuan të më izolojnë në mënyrë më, më jo të njerëzore nga të gjitha institucionet ndërkombëtare, ju kërkuan vendeve të tjera të vendosin sanksione. Fatmirësisht që të gjithë pa përjashtim refuzuan, edhe ata që më njihnin dhe ata që s'më njihnin, sepse kjo ishte një kërkesë pa asnjë mbështetje as ligjore, as dokumentare.

Kjo ndaj dhe unë pse do të lloboja unë? Unë mendova... personalisht, në atë administratë, shumicën e tyre, përfshirë dhe presidentin e kisha takuar më shumë se një herë, dy herë ose më shumë. Pra unë e njihja. Çfarë të thoja, ma hiqni? Jo, unë i njihja ata. Dhe unë zgjodha atë rrugë, nuk jam i penduar. Vjen keq që gjykatësi francez midis ligjit dhe një hapi në histori, zgjodhi burokracinë politike dhe e mbyllën me atë çështje, duke kaluar në fakt në shkallë të tre shkallë, se Sekretari i Shtetit ka imunitet. Çka nuk është e vërtetë. Nuk ekziston asnjë formë imuniteti për shpifjen sepse shpifja nuk është funksion shtetëror i askujt.

Çim Peka: Po thoni se gjykatat franceze e kanë kaluar tre shkallët duke e mbyllur me argumentin se sekretari ka imunitet?

Sali Berisha: Njëherë, njërin, në njërin shkallë thonë se jo, nuk je qytetar i Bashkimit Europian, pikë që s'qëndronte fare. Pastaj përdorën imunitetin. Nuk mund të, nuk mund të procedojmë Sekretarin e Shtetit sepse ai është person me imunitet. Jo, nuk duan ata, aty. Por unë ato mundësi kisha. Mbase në një vend tjetër mund të kishte funksionuar më shumë, nuk e di.

ETIKETA [Sali Berisha](#)

SHKARKO APP

[iPhone](#)

[Android](#)


 Logo KOHA JONË SONDASH

A duhet liruar Erion Veliaj të drejtojë bashkinë nga zyra?


☐ Po

☐ Jo

[Më shumë nga Lajme](#)



[Pagat e gjyqtarëve e prokurorëve, Manjani: Kanë vepruar haptazi në më...](#)



[Të shtunën protesta e madhe, mesazhi i protestuesit: Presim diasporën...](#)



[Kryeparlamentari Peleshi: Bashkëpunimi parlamentar me Austrinë do të ...](#)



[Protestuesi hedh akuza të forta: Shqipëria është kthyer në Kolumbi, k...](#)




[103 ditë protestë, protestuesi: Vij nga Athina, Rama i ka bërë të gj...](#)






[Trump ndez Konventën e Republikanëve në Teksas, Berisha: Dita e parë ...](#)

[LAJMET E FUNDIT](#)



[Pagat e gjyqtarëve e prokurorëve, Manjani: Kanë vepruar haptazi në mënyrë të paligjshme](#)

8 minuta më parë



[Shehaj përplasjet me Rexhajn për dosjen e Ballukut, analisti: Ajo dy herë ka shkuar në Green Coast](#)

18 minuta më parë



[Berisha flet nga Amerika për heqjen e "non-gratës": Vendimi ishte lobim nga Rama dhe Soros. Ndoqa rrugën ...](#)

27 minuta më parë




[7 vatra aktive zjarri, flakët vijnë në Dajt. Ministria e Mbrojtjes: Ndërhyjnë 400 forca dhe ushtria](#)

49 minuta më parë



["Kujtoni fëmijët që kemi përcjellë jashtë", Vatnikaj: Mafia është ende në pushtet, nuk duhet të kemi frikë](#)

1 orë e 8 minuta më parë



[Champions/ 2 barazime në 2 sfidat e para të mbrëmjes, Roma ngec ndaj Fenerbahce-s](#)

1 orë e 13 minuta më parë

[Më shumë lajme të fundit](#)

[LAJMET KRYESORE](#)





Te “Rana e Hedhun” në Shëngjin janë sulur biznesmenë, mafiozë, politikanë, shtetarë, mediatikë,....



Gjyqtarët ultimatum institucioneve: Pagat duhet të zhblokohen, vendimi i Kushtetueses të zbatohet menjëherë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.